

VENDIM
Nr. 336, datë 9.6.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR, DHE PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM, PA SHPËRBLIM, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARKIVAVE, TË KOMPONENTIT “OBJEKTI NR. 38”, PJESË PËRMBËRËSE E PRONËS ME NUMËR RENDOR 1332, ME EMËRTIMIN “ISH-SHTABI I BRIGADËS”, PJESË E PASURISË 201/84, NDODHUR NË ZONËN KADASTRALE 8541, GJIROKASTËR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 901 e vijues, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 11 e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, bashkëlidhur vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, përmasat e komponentit “Objekti nr. 38”, pjesë përbërëse e pronës me numër rendor 1332, me emërtimin “Ish-Shtabi i Brigadës”, pjesë e pasurisë 201/84, ndodhur në zonën kadastrale 8541, Gjirokastrë, ndryshohen sipas përmasave të përcaktuara në plan-rilevimin e planimetrit, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Prona e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, jepet në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, për një periudhë 7-vjeçare, nga Ministria e Mbrojtjes te Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, për ushtrimin e funksioneve administrative.

3. Ministria e Mbrojtjes dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të lidhin marrëveshje për dhënie në përdorim, pa shpërblim, të pronës, sipas pikës 1, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE


PRONARI : SHTET

DATE 11.02.2021

QELIMI PER REGJISTRIM

VENDNDODHJA
BASHKIA : GJIROKASTER DVASHK : GJIROKASTER ZONA KADASTRALE : 8541 NUMRI PASURISE 201/84(38) INDEX HARTE : K-34-137 (181-A)
TE DHENAT E PASURISE
LLOJI PASURISE : TRUALL SIP.PASURISE = 294.0 m2 SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT = 294.0 m2 NUMRI KATEVE : 1

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1	VERI			281/84		
2	JUG			281/84		
3	LINDJE			281/84		
4	PERENDIM			281/84		

REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT

EMRI: _____

LICENCA: NR. _____ DATE _____

KOMPANIA: _____

NIPT: _____

NENSHKRIMI/VULA _____

REALIZOI PER ASHK

SPECIALISTI _ SHPETIM KORMAKU

ASHK _____

NENSHKRIMI _____

KONFIRMOI

PERGJEGJESI _ ANGELO MEZINI

NENSHKRIMI / VULA _____

TEKNOLOGJIA E MATJEVE: T, Z, O

Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash;

PERCAKTIMI KUFIRIT: HK

Kode per percaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale;

SHENIME TE VECANTA:

PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET


EMRI _____

NENSHKRIMI _____

Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale

PLANIMETRIA E KATIT PERDHE

SHKURTYRI
TITULLI VENDOR



Sip. ndërtimi 279 m2